

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9616, datë 27.09 2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Kulturës
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Faza e Konsultimit nëntor 2019
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	-VKM nr.37 date 24.1.2018 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim ne KM (Matrica) -VKM nr. 246, datë 9.5.2018 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2018–2020 ”Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura"
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	9 Nentor 2018
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Nëntor 2018
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2018-MK-01
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Elira Dani , Drejtor Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator Elira.Dani@kultura.gov.al Mimoza Hysa , Drejtor Drejtorja e Integrimin, Koordinimit, Marrëveshjes dhe Asistencës Mimoza.Hysa@kultura.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Problemi që merret në shqyrtim është rënia e theksuar e interesit për librin, kriza e leximit kuptuar si varfërim kulturor, social dhe ekonomik i popullatës. Libri dhe leximi prezantojnë instrumente themelore për rritjen e kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë të një vendi. Kriza e leximit në vend pasqyrohet në rënien e lexuesit, uljen e numrit të botimeve në vit, uljen e numrit të blerësve. Kultivimi i edukatës së leximit është një proces i gjatë dhe i vështirë që kërkon ndërmarrjen e një seri masash dhe politikash. Mungesa e strukturave të posaçme që merren me politikat librore, si dhe nevoja e ndërhyrjeve në nr. 9616, date 27.9.2006 “Per librin ne R.SH”, për të krijuar lehtësira fiskale për shtëpitë botuese janë dy nga problemet kryesore me ndikim të drejtpërdrejtë në krizën e librit.	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?</i>	

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

1. Objektivat : Ndryshimi i TVSH-së, për librin, prej janarit 2006 është 20% në blerje dhe 0 % ne shitje.
2. Përfshirja nga procedurat e prokurimit për blerjen e librit, për të pasuruar fondet e sistemit bibliotekar kombëtar me vepra me karakter kulturor, shkencor, teknik apo teknologjik të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Kjo politikë do të sillte dhe lehtësira për furnizimin e Bibliotekës Kombëtare dhe rrjetin e bibliotekave publike, dhe për tju përgjigjur kërkesave specifike të komunitetit.
3. Lehtësimi nga numri i ekzemplarëve të kopjeve të detyruara që dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare dhe bibliotekat vendore
4. Krijimi i Qendrës Kombëtare të Librit nëpërmjet hartimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave do të ndikojë drejtpërdrejt në shtimin e kapaciteteve financiare dhe burimeve njerëzore në dispozicion në fushën e librit.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: Status quo-ja.

Opsioni 1 (i preferuar): Rishikimi i disa dispozitave të Ligjit Nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”.

Opsion i mëposhtem është vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 1 (i preferuar):

Pasqyron ndryshimet e vazhdueshme të ndodhura në fushën e librit, t’i përgjigjet zhvillimeve të teknologjisë dhe digjitalizimit në fushës së botimeve, të korrigojë dhe të përmirësojë klimën e botimeve, t’u vijë në ndihmë krijuesve, botuesve dhe operatorëve që veprojnë në fushën e librit.

Heqja procedurave e prokurimit blerjen e librit, për të pasuruar fondet e sistemit bibliotekar kombëtar me vepra me karakter kulturor, shkencor, teknik apo teknologjik të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Kështu shprehet dhe vullneti për të lehtësuar Bibliotekën Kombëtare dhe rrjetin e bibliotekave publike në Shqipëri nga procedura e prokurimit, në ato raste kur bëhet fjalë për blerjen e librave dhe materialeve të një rëndësie të veçantë që hyjnë në kategorinë e fondeve të rralla, të cilat në asnjë rast nuk mundet të tenderohen për vet specifikën e tyre. Libri nuk ka specifikime teknike dhe ekskluzivitetin e shtypjes dhe botimit e ka vetëm një shtëpi botuese, me çmim fiks. Kjo politikë do të sillte dhe lehtësira për Bibliotekën Kombëtare dhe rrjetin e bibliotekave publike

Ulja e barrës fiskale të botuesve dhe uljen e çmimit të librit, nëpërmjet reduktimit të TVSH-se, për shtëpitë Botuese. Përfshirja nga heqja e TVSH-së do të jenë edhe shtëpitë botuese, materialet e ofruara në format tradicionale dhe elektronike të librit, panvarësisht përmbajtjes së tij duke përfshirë dhe platformat elektronike (e-libri). Synohet të barazohet ky tatim i cili do të behet i barabartë në të dy kahët. Prej janarit 2006, TVSH për librin është 20% për shtëpitë botuese dhe 0 % ne shitje.

Synohet decentralizimin e politikës së librit nëpërmjet krijimit të një Qendre për Librin dhe Leximin e cila do të funksionojë si organ zbatues i politikave në fushën e librit të hartuara nga Ministria përgjegjëse për librin.

Lehtësimi nga numri i ekzemplarëve të kopjeve të detyruara që dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare dhe bibliotekat vendore, është një tjetër hap që ka për qëllim të reformojë dhe

lehtësojë marrëdhënien ndërmjet botuesve dhe institucioneve të ruajtjes së kujtesës në vend, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standarteve bashkëkohore.

Avantazh është ulja e çmimit të librit në publik duke ruajtur parametrat tipografik dhe përmbajtësor. Ulja e çmimit sjell rritje të tirazhit për shkak të thithjes së lexueshmerisë në një shkallë më të lartë. Kjo sjell prodhim dhe marketing në shkallë më të gjere dhe potencial më të lartë ekonomik të librave të printuar me teknologjinë e shtypshkrimit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuara dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuara mbi buxhetin dhe bizneset.

Status quo-ja:

Aktualisht, me ristrukturimin e institucioneve qendrore, në Ministrinë e Kulturës nuk ka një drejtori të posaçme që merret me zbatimin e politikave të librit. Mungon gjithashtu një institucion varësie që të ketë në misionin e tij detyrën e zbatimit të politikave librore dhe sidomos nismat për përhapjen e librit dhe kulturës së leximit. Nuk ka gjithashtu masa lehtësuese për pasurimin e bibliotekave shkollore dhe publike. Mungojnë në ligjin aktual lehtësirat për librin elektronik, një prej zhvillimeve më të rëndësishme në të ardhmen në fushën e librit. Ligji aktual për Librin paraqitet i paplotë dhe me mangësi për të përballuar zhvillimet e kohës. Aktualisht buxheti për politikën librore në Ministrinë e Kulturës është pjesë e buxhetit për artin dhe kulturën, dhe paraqitet i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat për një program të qendrueshëm e afatgjatë për edukimin përmes librit dhe leximit

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është opsioni 1. Opsioni do të sigurojë bazën ligjore, për përmisimin e politikave në fushën e librit.

Opsioni do të sigurojë reduktimin e tatimit mbi vlerën e shtuar, ulja e kopjeve të detyruara, përjashtimi nga procedurat e prokurimit publik për qarkullimin e librit nëpërmjet procesit të shit-blerjes dhe impaktit në publik. Duke ju përmbajtur këtyre parametrave prodhuesit e librit (botuesit) kanë një siguri më të lartë në konsolidimin dhe shtimin e titujve të librave të botuar dhe tirazheve përkatëse, duke mundur që në R.SH të botohen mbi 1000 tituj librash në vit, dhe tirazhet të mos jenë më pak se 500 kopje për çdo titull edhe për librat jokomerciale.

Gjithashtu opsioni 1 Synon që nëpërmjet kësaj politike që detyrimi i botuesve për të dorëzuar kopje të detyruara të librave të botuar nga 5 që është aktualisht në 3,

Aktualisht, botuesit detyrohen të dorëzojnë, në Bibliotekën Kombëtare, në Bibliotekën e Kuvendit të R.SH, dhe në bibliotekat publike pranë njësive administrative vendore, ku ushtrojnë veprimtarinë, nga 5 kopje për çdo botim. Synohet që detyrimi për dorëzimin e kopjeve të botimeve të bëhet 3. Nëpërmjet këtij ndryshimi do të krijohet një lehtësi për shtëpitë botuese të cilat i dorëzojnë kopjet e botimit falas në këto institucione dhe ulja e numrit të kopjeve të detyruara për dorëzimi për çdo botim i lehtëson nga shpenzimet. Ky propozim është një tjetër hap që ka për qëllim të reformojë dhe lehtësojë marrëdhënien ndërmjet botuesve dhe institucioneve të ruajtjes së kujtesës në vend, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standarteve bashkëkohore .

Gjithashtu, duke qene që rrjeti kombëtar i bibliotekave publike të mundet të përjashtohet nga procesi i prokurimit, do të arrihet që nëpërmjet një procesi vlerësimi dhe testimi të plotësojë nevojat e publikut dhe institucioneve bibliotekare sipas kushteve dhe mungesave në tituj prej të cilave vuajnë aktualisht këto institucione.

Disavantazh në rast mosmiratimi të projektligjit është ruajtja e kuotave të larta për librin tradicional (letër), që sjell përballjen me traditën e re të librit elektronik, i cili sot është trend botëror. Ruajtja e traditës të librit të printuar sjell impakt jopozitiv në sferën e ruajtjes së resurve ambientale (një libër –një peme) dhe mbetet i kërcënuar nga kufizimi i hapësirave të ruajtjes dhe përpunimit në shtimin bibliotekar (problem global).

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 1: Opsioni 1 është i preferuar krahasuar me status quo-ne, sepse synon zgjidhjen e ngërçeve dhe problemeve të krijuara nga mungesa e institucioneve që kanë si objekt parësor zbatimin e politikave librore në vend, si dhe problemeve të krijuara nga mangësitë në kuadrin ligjor aktual. Me uljen e kostos së librit që reflektohet në uljen e çmimit në publik do të mundet të përthithim komunitetin e lexuesve me një rritje graduale 4 deri në 6% në vit dhe do të kemi një rritje graduale 2 deri në 3% të titujve të botuar, dhe për rrjedhojë një konsolidim të rritjes të tirazheve që do të variojë nga 500 deri në 1000 ekzemplare në vit për titull libri. Për rrjedhojë me këtë progresion synohet rritja e kapitalit financiar për librin nga subjektet botuese dhe një rritje të kontributit në ekonominë shqiptare. Përmirësimet në këtë ligj gjithashtu do të bëjnë decentralizimin e politikës së librit nëpërmjet krijimit të një Qendre për Librin dhe Leximin e cila do të funksionojë si organ (me VKM).

Një nga objektivat kryesorë që synon të arrijë kjo qendër është rritja e kapaciteteve financiare: në këto pesë vite buxheti për librin është luhatur në vlerën prej 30.000 lekë vjetorë, vlerë kjo e pamjaftueshme për përballimin e problematikave të kohës në fushën e librit. Ndihmesë në rritjen e buxhetit në fushën e librit në këto pesë vite ka qenë dhe sigurimi i fondeve të jashtme financiare përmes anëtarësimit në programe si “Europa Krijuese” dhe “Traduki” për organizatat kulturore dhe shtëpitë botuese shqiptare, të cilat nga 2014 deri në 2018 kanë përfituar një vlerë prej 1.432.643,78 eurosh.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Puna për konsultimet e realizuara për ligjin nr. 9616, datë 27. 09 2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” ka filluar që në 2016, ku është diskutuar me grupet kryesore të interesit që operojnë në fushën e librit. Konsultimet kanë filluar që në 2016, me një takim informues me Shoqata e Botuesve “Aleanca për Librin” Shoqëria e Librit Shqip, Shkrimtarë dhe përkthyes, Shoqatave të botuesve, shkrimtarëve dhe përkthyesve.

Gjate fazës së konsultimeve me grupet e mësipërme nëpërmjet mbledhjes së KKNL-se, takimeve të përbashkëta, dhe korrespondencës zyrtare, është arritur propozimet të cilat janë reflektuar në draftin e projektligjit.

*Te gjitha komentet janë hedhur në tabelen për perpunimin e të dhënave në funksion të hartimit dhe raportit për njoftimin dhe konsultimin publik, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 653, datë 14.9.2016, e cila do të bashkëlidhet projektligjit.

Paraprakisht lista e subjekteve që është dërguar shkresë për të pasyqruar të dhëna mbi situatën mbi librin dhe për të kontribuar në dokumentin e i Raportit të Ndikimit të Vlerësimit janë:

- Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, me shkresën nr. 7257, datë 19.9.2018;
- Shoqatës “Aleanca e Librit Shqip”, me shkresën nr. 7256, datë 19.9.2018;
- Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, me shkresën nr. 7258, datë 19.9.2018;
- Shoqërisë së Librit Shqip, me shkresën nr. 19.9.2018;
- Institutit të Statistikave, me shkresën nr. 7254, datë 19.9.2018;
- Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me shkresën nr. 8140, datë 24.10.2018.

*Te gjitha komentet janë hedhur ne tabelen per perpunimin e te dhënave ne funksion te hartimit dhe raportit per njoftimin dhe konsultimin publik, sipas formatit te miratuar me VKM nr. 653, date 14.9.2016.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Projektligji parashikon miratimin e vendimeve të caktuara të Këshillit të Ministrave, të cilat do të mundësojnë zbatimin e tij nga institucionet zbatuese të varësisë. Njëra ngakëto do të jetë dhe Qendra Kombëtare për librin dhe leximin. Zbatimi dhe monitorimi do të sigurohet nga institucione shtetërore si më poshtë:

- Ministria përgjegjëse për librin
- Ministria e Financave dhe Ekonomise
- Qendra Kombëtare për Librin dhe Leximin
- Institucionet e vetëqeverisjes vendore
- Grupet e interesit si shoqatat e botuesve(Shoqata “Aleanca e Librit Shqip, Shoqata e Botuesve Shqiptarë, Shoqëria e Librit Shqip,) shkrintareve dhe përkthyesve qe drejtojnë projekte te rëndësishme per librin me mbeshteten e MK dhe instancave nderkombetare

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Historiku dhe tradita librore në Shqipëri ka qenë e lidhur ngushtë me të drejtën e shqiptarëve për identitet, pavarësi dhe integrim, por ngritja dhe mbrojtja e kësaj kauze në nivel insitucional, ka një përvojë relativisht të re në krahasim më fushat e tjera si arkeologjia, trashëgimia kulturore apo edhe disiplinat e tjera të artit dhe kulturës.

Në këtë aspekt, ndonëse fusha e librit pas rënies së regjimit komunist fitoi një përmasë të re dhe të synuar prej dekadash nga protagonistët e tij, Ministria e Kulturës mundi të krijonte të parën strukturë të veçantë të saj në vitin 1998, Drejtorinë e Librit. Përgjatë viteve të para të tranzicionit Ministria e Kulturës hartoi, dhe miratoi Ligjin Nr. 8576, datë 03.02.2000 Për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar si edhe Ligjin Nr. 9616, datë 27. 09 2006, i ndryshuar, duke vijuar me përcaktimin mbi baza ligjore të Fondit Kombëtar për Librin, ngritjen e Këshillit Kombëtar të Librit dhe Nxitjes së Leximit si edhe Këshillin Kombëtar të Bibliotekave, duke krijuar në këtë mënyrë hapësirat e duhura për transparencë e decentralizim për mbështjetjen e botimeve, veprimtarive kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e librit dhe bibliotekave, si edhe frymën e partneritetit me strukturat homologe ndërkombëtare. Bazuar në legjislacionin e sipërcituar nën autoritetin e Ministrisë së Kulturës funksionojnë Këshilli Kombëtar i Librit dhe Nxitjes së Leximit dhe Këshilli Kombëtar i Bibliotekave, dy organe të nivelit sipëror që e ushtrojnë veprimtarinë dhe funksionalitetin e tyre pranë Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë. Këto akte ligjore kanë patur impakt pozitiv në kohë kur janë miratuar por nuk i përgjigjen zhvillimit dhe ndryshimeve të ndryshme në kohë.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*

- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi që merret në shqyrtim është rënia e theksuar e interesit për librin, kriza e leximit kuptuar si varfërim kulturor, social dhe ekonomik i popullatës. Ky problem nuk ka karakter vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar. Libri dhe leximi prezantojnë instrumente themelore për rritjen e kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë të një vendi. Në Kushtetutën e Shqipërisë garantohet me ligj dhënia e mundësisë së çdo qytetari për të qenë i lirë, i barabartë, si dhe detyrimin për zhvillimin e shoqërisë dhe individit. Këto objektiva mund të arrihen vetëm nëpërmjet kapacitetit që kanë qytetarët e mirëinformuar për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për të qenë pjesëmarrës aktivë në jetën sociale dhe publike. Zhvillimi i shoqërisë ka nevojë për individë të përgatitur, por mbi të gjitha ka nevojë për një akses të lirë pa pengesa ndaj informacionit, kulturës dhe mendimit. **Afirmimi i vlerave të librit dhe të leximit nënkupton garantimin jo vetëm të rritjes kulturore, por edhe rritjen e ekonomisë dhe të punësimit.**

Kriza e leximit në vend pasqyrohet në rënien e lexuesit, uljen e numrit të botimeve në vit, uljen e numrit të blerësve. Kultivimi i edukatës së leximit është një proces i gjatë dhe i vështirë që kërkon ndërmarrjen e një seri masash dhe politikash. Mungesa e strukturave të posaçme që merren me politikën librare, si dhe nevoja e ndërhyrjeve në Ligjin e Librit për të krijuar lehtësira fiskale për shtëpitë botuese janë dy nga problemet kryesore me ndikim të drejtpërdrejtë në krizën e librit.

Problemi duhet kuptuar si ndërgjegjësim jo thjesht për leximin si kënaqësi estetike, por si bazë për edukimin e mendimit kritik të qytetarëve mbi politikën në vend, si mundësi për të ndikuar në rritjen ekonomike të grupeve të interesit të lidhur drejtpërdrejt me librin dhe për të ndikuar në mënyrë të tërthortë në përmirësimin e jetës së qytetarëve përmes dijes. Çështja e lexueshmërisë në vend duhet kuptuar si problem bazë që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së individëve, në nivelin e formimit të tyre profesional, në uljen e nivelit të kriminalitetit në vend. Statistikat e vendeve të Bashkimit Europian dëshmojnë gjithashtu se lexueshmëria është në përpjestim të drejtë me zhvillimin ekonomik të një vendi.

ANKETA E ARSIMIT TË TË RRRITURVE PUBLIKUAR NGA INSTAT

INSTAT publikon për herë të parë rezultatet e Anketës së Arsimit të të Rriturve 2017, e cila i referohet popullsisë së moshës 25-64 vjeç. Rezultatet e Anketës së Arsimit të të Rriturve 2017, ndër të tjera tregojnë se:

Sipas INSTAT, 69.3% e shqiptarëve nuk kanë lexuar asnjë libër, 21.5% kanë lexuar më pak se 5 libra, 6.8% kanë lexuar 5 deri në 10 libra, dhe 2.2% kanë lexuar mbi dhjetë libra.

Gjatë 2017, 30,7 % e popullsisë 25-64 vjeç kanë lexuar të paktën një libër gjatë kohës së lirë. Femrat tregojnë interes më të lartë në leximin e librave gjatë kohës së lirë, 35,8 % e tyre kanë lexuar të paktën një libër, kundrejt 25,6 % të meshkujve, gjatë 12 muajve të fundit.

Shqiptarë të moshës mbi 25 vjeç raportuan se kanë lexuar më pak se 5 libra vitin e kaluar. Teksa pjesa e tyre që kanë lexuar më shumë se kaq sa vjen e zvogëlohet. Rreth 102 mijë shqiptarë raportojnë se kanë lexuar 5-10 libra gjatë vitit të kaluar, ndërsa rreth 44 mijë shqiptarë kanë lexuar më shumë se 10 libra gjatë vitit të kaluar. Gjithashtu, numri i frekuentimeve në Bibliotekën Kombëtare zbriti në 88 mijë, nga mbi 150 mijë që kishte qenë në vitin 2016.

Eshte perdorur metoda krahasuese e statistikave të INSTAT me ato të EUROSTAT¹ si mjete me efikas per te krijuar renditjen e duhur dhe klasifikimin e cdo treguesi te matshem. Rezulton se Shqiperia (69.3%), Turqia dhe Rumania kane perqindjen me te madhe te

¹ http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/soe.do?dataset=cult_pcs_bka&lang=en

personave qe nuk kane lexuar asnje liber gjate 12 muajve te fundit ne periudhen qe jane kryer anketat.

Tabela: Gazeta dhe libra të lexuar sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor të arritur dhe shpeshësisë²

	Gazeta					Libra			
	Çdo ditë	Të paktën një herë në javë	Të paktën një herë në muaj	Më pak se një herë në muaj	Asnjëherë	Asnjë	Më pak se 5	5 deri ne 10	10+
Gjithsej	583.196	369.732	213.155	127.589	205.275	1.033.537	320.873	102.537	33.931
Meshkuj	355.800	187.281	90.909	38.654	83.361	559.898	131.579	49.000	12.290*
Femra	227.396	182.451	122.247	88.935	121.914	473.639	189.294	53.537	21.641*
25-34	176.808	91.363	60.664	39.422	51.673	237.127	126.033	43.335	**
35-44	118.702	94.669	42.659	24.822	48.804	239.797	65.449	13.978*	**
45-54	149.075	99.706	49.080	34.332	52.626	280.149	68.554	26.833	7.847*
55-64	138.610	83.995	60.752	29.013	52.172	276.464	60.837	18.390*	**
Cikli i ulët dhe i lartë i arsimit të detyruar (ISCED 0-2)	176.512	194.490	119.788	66.838	147.493	609.356	72.190	14.871*	**
E mesme e përgjithshme/profesionale (ISCED 3-4)	239.976	130.409	62.794	42.221	44.789	358.433	119.489	31.226	**
E lartë/Master/PhD (ISCED 5-8)	166.467	44.834	28.564	18.529*	11.191*	63.321	127.568	56.439	22.128*

STATISTIKA – EUROSTAT

Të dhënat mbi pjesëmarrjen kulturore (modelet e leximit, ndjekja e ngjarjeve kulturore dhe vendet e vizituara kulturore) vijnë nga një modul specifik për pjesëmarrjen kulturore të Anketës së Arsimit të Rriturve (AES) të kryer në vitet 2007 dhe 2011.

Persona që lexojnë libra gjatë 12 muajve të fundit sipas gjinisë, dhe moshës. (26 deri 64 vjeç)
Përditësimi i fundit: 26.2.2016

Burimi i të dhënave: EUROSTAT³


Asnje	1 liber ose me shume	Me pak se 5 libra	5 deri ne 9 libra	Me shume se 10 libra	Pa pergjigje
-------	----------------------	-------------------	-------------------	----------------------	--------------

TIME	2007	2011	2007	2011	2007	2011	2007	2011	2007	2011	2007	2011
GEO												
Belgium	32.5	:	64.2	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Bulgaria	47.9	50.4	52.1	48.2	:	24.5	:	14.4	:	9.2	:	:
Czech Republic	21.7	33.3	78.3	66.7	:	31.3	:	16.2	:	19.2	:	:
Germany (until 1990 former territory of the FRG)	27.0	24.7	72.8	75.3	:	28.6	:	24.5	:	22.1	:	:
Estonia	25.0	29.9	75.0	70.1	:	28.7	:	19.4	:	21.9	:	:
Greece	47.4	49.0	48.3	48.8	:	30.6	:	10.4	:	7.8	:	:
Spain	39.0	41.9	60.8	58.0	:	35.1	:	10.2	:	11.7	:	1.0
Croatia	46.8	:	52.4	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Italy	50.9	45.8	46.6	54.1	:	25.9	:	10.6	:	17.3	:	0.3
Cyprus	45.6	48.1	54.4	51.9	:	30.8	:	11.5	:	9.6	:	:
Latvia	27.8	35.9	71.1	64.1	:	26.1	:	19.2	:	18.8	:	:
Lithuania	33.6	45.3	66.4	54.7	:	28.7	:	12.4	:	13.5	:	:

² <http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punës-dhe-arsimi/të-mësuarit-gjatë-gjithë-jetës/#tab3>

³ http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/soëë.do?dataset=cult_pcs_bka&lang=en

Luxembourg	:	17.9	:	81.9	:	33.5	:	23.9	:	24.4	:	:
Hungary	38.2	38.6	61.8	61.4	:	32.9	:	14.4	:	14.1	:	:
Malta	44.9	47.5	55.1	52.5	:	:	:	:	:	:	:	:
Austria	25.1	26.8	74.8	73.0	:	32.0	:	20.4	:	20.6	:	:
Poland	39.1	43.5	60.9	56.3	:	24.8	:	13.8	:	17.6	:	:
Portugal	57.8	59.5	42.2	40.5	:	26.3	:	9.0	:	5.2	:	:
Romania	59.5	68.4	38.7	29.6	:	20.1	:	6.6	:	2.8	:	:
Slovenia	35.2	45.9	64.8	54.1	:	21.8	:	13.1	:	19.2	:	:
Slovakia	26.4	33.9	73.4	66.1	:	36.2	:	17.9	:	12.0	:	:
Finland	20.6	27.2	79.3	72.7	:	30.5	:	17.9	:	24.4	:	:
Sëeden	16.3	:	83.3	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Serbia	:	46.4	:	52.8	:	23.2	:	13.3	:	16.1	:	:
Turkey	62.1	69.4	37.9	30.6	:	19.1	:	6.8	:	4.7	:	:



RAPORT I KE-EUROSTAT, NE DITEN BOTERORE TE LIBRIT, 23.4.2018

“Eurostat” raporton se rreth 20% e popullsisë janë lexues të rregullt. Në vitin 2016, familjet në Bashkimin Europian (BE) shpenzuan mbi 90 miliardë euro ose 1.1% të shpenzimeve totale të tyre të konsumit në libra dhe gazeta. Kjo përfaqëson 0.6% të GDP-së së BE-së ose rreth 200 euro për banor të BE-së. Një studim i kryer në 15 vende të BE midis 2008 dhe 2015, tregon se koha mesatare e leximit të librave shkon nga 2 minuta në ditë në Francë dhe 5 minuta në Itali, Austri dhe Rumania për 10 ose më shumë minuta në Estoni, Finlanda dhe Polonia. Anketa mbulonte grupmoshat 20 deri në 74 vjeç. Në Finlandë, 16.8% e popullsisë përcaktuan leximin si një nga aktivitetet që ata kalonin kohë e lirë. Ato u pasuan nga Polonia (16.4%), Estonia (15.0%), Greqia dhe Luksemburgu (të dyja

11.9%). Në anën tjetër të shkallës, Franca (2.6%), Rumania (6.2%), Austria (7.2%) dhe Belgjika (7.9%) kishin pjesën më të ulët të të anketuarve që lexonin libra.⁴

RAPORT I KOMISIONIT EUROPIAN I VITIT 2013

Raporti i Komisionit Europian i vitit 2013, shprehet se 90% e të anketuarve në Suedi, 86% në Hollandë dhe 82% në Danimarkë kanë lexuar së paku një libër vitin e kaluar. Në kontrast, vendet jugore dhe lindore shpesh janë më së paku të angazhuara, vetëm 51% e të anketuarve në Rumani dhe 50% në Greqi kanë lexuar së paku një libër në vitin e fundit (krahasuar me 68% në BE në tërësi).⁵

QB1.9 How many times in the last 12 months have you...?

	Read a book					Total 'At least once'
	Not in the last 12 months	1-2 times	3-5 times	More than 5 times	Don't Know	
EU27	32%	19%	12%	37%	-	68%
Sex						
Male	36%	20%	13%	31%	-	64%
Female	28%	18%	12%	42%	-	72%
Education (End of)						
15-	55%	15%	6%	23%	1%	44%
16-19	35%	21%	13%	31%	-	65%
20+	17%	17%	15%	51%	-	83%
Still studying	13%	21%	18%	48%	-	87%
Respondent occupation scale						
Self-employed	28%	20%	14%	37%	1%	71%
Managers	10%	16%	15%	59%	-	90%
Other white collars	25%	24%	17%	34%	-	75%
Manual workers	38%	22%	12%	28%	-	62%
House persons	46%	18%	9%	26%	1%	53%
Unemployed	41%	21%	11%	26%	1%	58%
Retired	39%	14%	9%	38%	-	61%
Students	13%	21%	18%	48%	-	87%

INFORMACION I Mbledhur nga Bibliotekat e Qyteteve

Qyteti	Popullsia	Lexues	%
Vlorë	124000	7653	6.17%
Fier	267000	58304	21.84%
Korçë	86176	32544	37.76%
Durrës	205849	8452	4.11%
Berati	69000	3000	4.35%
Lezhë	58000	40326	69.53%
Librazhd	10158	1020	10.04%
Kuçovë	48288	15228	31.54%
Devoll	12000	190	1.58%
Bulqizë	67000	109	0.16%
Ballsh	43000	103	0.24%
Roskovec	12000	600	5.00%
Klos	15000	120	0.80%
Patos	24000	2856	11.90%
Shijak	12893	57	0.44%
Libohovë	7158	250	3.49%
Shkodër	114219	5100	4.47%
Elbasan	128232	5200	4.06%
Krujë	20400	990	4.85%

⁴ <https://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/products-eurostat-neës/-/EDN-20180423-1>

⁵ http://ec.europa.eu/commfrontoffice/publicopinion/archives/ebs/ebs_399_en.pdf,

Dibër	144598	1500	1.04%
Ersekë	3746	300	8.01%
Tropojë	5606	600	10.70%
Lushnjë	54813	3700	6.75%
Burrel	10862	1530	14.09%
Pukë	4800	600	12.50%
Tepelenë	12000	425	3.54%
Memaliaj	10657		0.00%
Çorovodë	8400	219	2.61%
Gramsh	24235	4800	19.81%
Kukës	16765	1046	6.24%
Sarandë	41000	1680	4.10%
Gjirokastrë	60000	3500	5.83%
Mirditë	14264	1360	9.53%
Peqin	8942	1600	17.89%
Përmet	12700	3000	23.62%
Koplik	12000	400	3.33%
Kavajë	29354	2300	7.84%
TOTAL		21.0662	10.26%

Nga të dhënat e mbledhura zyrtarisht nga bibliotekat e qyteteve rezulton se përqindja e lexuesve në krahasim me numrin e popullsisë të qyteteve perkatete rezulton e ulët, dhe mesatarja totale e lexuesve të bibliotekave të qyteteve nga të cilët është marrë informacioni është 10.26 %.

STATISTIKA DATA CENTRUM

Instituti studimor **Data Centrum**⁶ zhvillon një studim sasior prej N=1000 të anketuarish për të hulumtuar perceptimin publik mbi çështjet sociale, ekonomike dhe politike si edhe zakonet e menyrën e jetesës së shqiptarëve.

Për pyetjen: Duke përjashtuar tekstet shkollore, gjatë 12 muajve të fundit, a keni lexuar libra fizikë (print)? Po libra dixhitalë (e-books, audio books)?


Gati 1 në 3 shqiptarë lexojnë libra, kryesisht libra fizikë. Leximi i librave dixhitalë është një dukuri e rrallë – vetëm 2% e popullatës së përgjithshme 18-70 vjeçarë.

Sa më i lartë niveli i arsimit, aq më shumë rritet niveli i leximit të librave. 2/3 e popullatës që kanë përfunduar arsimin e lartë lexojnë libra fizikë dhe 7% lexojnë libra dixhitalë. Lexuesit e rregullt deklarojnë se kanë lexuar mesatarisht 9 libra në vitin e fundit dhe më pak se 2 libra në muajin e fundit. Kjo mesatare është ndjeshëm më e ulët tek lexuesit sporadikë (2 libra / vit). Lexuesit e rregullt janë kryesisht me arsim të lartë ose të mesëm. Lexuesit me arsim të ulët janë lexues mesatarë ose sporadikë. Të rinjtë deri në 34 vjeç kanë lexuar më shumë libra se ata 35+ vjeç gjatë muajit të fundit

⁶ Studimi zhvillohet në 12 qarqet e Shqipërisë, në zonat urbane dhe rurale.


Në total u intervistuan N=1000 individë, femra dhe meshkuj, 18-70 vjeç, kampion përfaqësues. Të dhënat për fazën e parë u mblodhën në datat 6-23 Shkurt 2018 nga një ekip me përvojë dhe i trajnuarposaçërisht për këtë studim

Duke përjashtuar tekstet shkollore, gjatë 12 muajve të fundit, a keni lexuar libra fizikë (print)? Po libra dixhitalë (e-books, audio books)?





Gati 1 në 3 shqiptarë lexojnë libra, kryesisht libra fizikë. Leximi i librave dixhitalë është një dukuri e rrallë-vetëm 2% e popullatës së përgjithshme 18-70 vjeçarë.

Duke përjashtuar tekstet shkollore, gjatë 12 muajve të fundit, a keni lexuar libra fizikë (print)? Po libra dixhitalë (e-books, audio books)?



Sa më i lartë niveli i arsimt, aq më shumë rritet niveli i leximit të librave. 2/3 e popullatës që kanë përfunduar arsimin e lartë lexojnë libra fizikë dhe 7% lexojnë libra dixhitalë



STATISTIKA OECD

Tabela e performancës së leximit logjik në 70 vende të botës të nxënësve në moshën 15 vjeçare, organizuar nga Organization for Economic Cooperation and Development (OECD), 2015-2016 përmes programit për gjendjen e nxënësve në nivel ndërkombëtar “The Program for International Student Assessment (PISA). Mbi 500 pikë është mbi mesatare, 450-500 pikë është mesatare, dhe nën 450 pikë është nënmesatare. Shqipëria renditet me 415.0 pikë, nën mesatare.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qeveria synon të rregulloje problematikat e renditura duke ndryshuar në mënyrë positive dhe duke i dhënë një hov të ri situatës në vend lidhur me librin dhe leximin. Këto ndërhyrje do të mundësojnë *lehtësimin e zbatimit të politikave të librit*, krijimin e kushteve për *rritjen e kapaciteteve financiare dhe shtimin e burimeve njerëzore* në dispozicion për fushën e librit, rritjen e mundësisë për sigurimin e *fondeve të jashtme dhe burimeve të tjera ndihmëse financiare* në fushën e librit, përfshirjen më të gjerë të krijuesve, përkthyesve dhe botuesve në projektet e librit dhe nxitjes së leximit.

- Ndërhyrjet e kryera në disa nene të rëndësishme të këtij projektligji kanë pasur në qendër të vëmendjes dhe synojnë një përmirësim të ndjeshëm të afrimit dhe përhapjes së librit shqip brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe promovimit të tij në hapësira të ndryshme mediatike, kulturore dhe intelektuale, kudo ku gjenerohet dhe ndihet nevoja për literaturën e librit shqip dhe atij të përkthyer. Në këto kushte, përshtatja e një terreni të mbarsur me një problematikë të trashëguar pas një procesi të gjatë tranzitiv, do të japë ndikimin e drejtpërdrejtë në përmirësimin e kësaj marrëdhënieje dhe do të përbëjë një dokument të rëndësishëm si shenjë e përkujdesjes nëpërmjet politikave specifike dhe zbatimit të objektivave për librin dhe krijuesit e tij, bazuar edhe në programin e Qeverisë Shqiptare dhe përparësive të saj, në këtë fushë të rëndësishme për kulturën e shkruar.

- Ndryshimet në ligjin aktual të librit do të ndihmonin për të lehtësuar barrën fiskale të botuesve dhe ulur çmimin e librit. Përmirësimet në këtë ligj gjithashtu do të bëjnë decentralizimin e politikës së librit nëpërmjet krijimit të një Qendre për Librin dhe Leximin e cila do të funksionojë si organ (me VKM).

- Reduktimi i TVSH-së, si në shitje edhe në blerje, do lehtësojë prodhuesit e librit, importuesit, lexuesit e librit në Republikën e Shqipërisë. Kjo pa dyshim që do të ndihmojë jo vetëm shitësit e librit të cilët kanë paguar TVSH-në me rastin e importimit, përkatësisht shitjes së librit por do të ndihmojë edhe blerësit e librit, ku libri do të jetë më i lirë në çmim se sa është deri më sot". Ndërkohë që kjo TVSH që rëndon mbi shtypshkronjat dhe shtëpitë botuese vendase, efektivisht pasqyrohet në çmimin e shitjes së librit, sepse është pjesë reale e koston të prodhimit për sa kohë nuk është e zbatueshme.

Është parashikuar që furnizimeve të shërbimeve të dhe materialet e tjera të ofruara në formën tradicionale dhe çdo formë tjetër elektronike, panvarësiht përmbajtjes së tij, që mund të lexohet nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse përfshirë dhe platformat elektronike (e –libri) përjashtohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

E- libri, libri elektronik është botim i librave të ofruara në formë digjitale, që përbëhen nga teksti, imazhe ose të dyja së bashku, të lexueshme në ekranin e sheshtë të kompjuterave ose pajisjeve të tjera elektronike. E përkufizuar si "një version elektronik i një libri të shtypur", disa e-libra ekzistojnë pa një ekuivalent të shtypur. E-libra mund të lexohen në pajisjet e posaçme për lexuesin, por edhe në çdo pajisje kompjuterike që përmban një ekran të kontrollueshëm, duke përfshirë kompjuterët desktop, laptopë, tabletë dhe smartphones.

E-libra gjithashtu referohen si "ebooks", "eBooks", "Ebooks", "e-Books", "e-revista", "e-editions" ose si "libra dixhitale". Pajisjet që janë dizajnuar posaçërisht për leximin e librave përkufizohen: "lexues elektronikë", "pajisje ebook" ose "eReaders/ e - lexues"

- Amendimet në legjislacionin e taksave konsistojnë në përmirësimin e klimës së editorisë dhe distribucionit në vend, lehtësimin e librit si produkt intelektual nga taksimi dhe ofrimi i mundësive dhe shansave të barabarta për të gjithë komunitetin e botuesve, atë të shkrimtarëve, përkthyesve, kritikës dhe studiuesve, veprat e të cilëve përveçse pasurojnë fondin e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore në fushën e librit, janë në vetvete edhe promotorë të zhvillimit dhe gjenerimit të vlerave dhe risive në këtë fushë.
- Lehtësimi nga numri i ekzemplarëve të kopjeve të detyruara që dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare dhe bibliotekat vendore, është një tjetër hap që ka për qëllim të reformojë dhe lehtësojë marrëdhënien ndërmjet botuesve dhe institucioneve të ruajtjes së kujtesës në vend, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standarteve bashkëkohore.
- Gjithashtu, në draftin që po paraqitet për amendim shprehet vullneti për të lehtësuar Bibliotekën Kombëtare dhe rrjetin e bibliotekave publike në Shqipëri nga procedura e prokurimit, në ato raste kur bëhet fjalë për blerjen e librave dhe materialeve të një rëndësie të veçantë që hyjnë në kategorinë e fondeve të rralla, të cilat në asnjë rast nuk mundet të tenderohen për vet specifikën e tyre.
- Krijimi i një qendre të posaçme për librin bën të mundur rritjen e kapaciteteve financiare meqenëse vetëm si e tillë, si institucion varësie me status të përcaktuar, mund të ishte pjesë e programeve ndërkombëtare për kulturën e veçanërisht për librin dhe leximin. Qendra mundëson hartimin dhe zbatimin e një strategjie ndërgjegjësimi në shkallë kombëtare për rëndësinë e librit dhe leximit, do të mundësonte mbledhjen e të dhënave dhe statistikave, të munguara deri tani për librin dhe leximin, do të mundësonte promovimin më efikas të letërsisë shqipe brenda dhe jashtë vendit, do të mundësonte krijimin e një rrjeti bashkëpunues dhe mbështetës mes shkollës, familjes, institucioneve librare e bibliotekare.
- Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit është rritja e kapaciteteve financiare: në këto pesë vite buxheti për librin ka qënë i pamjaftueshëm për përballimin e problematikave të kohës në fushën e librit. Ndihmesë në rritjen e buxhetit në fushën e librit në këto pesë vite ka qënë dhe sigurimi i fondeve të jashtme financiare përmes anëtarësimit në programe si “Europa Krijuese” dhe “Traduki” për organizatat kulturore dhe shtëpitë botuese shqiptare, të cilat nga 2014 deri në 2018 kanë përfituar një vlerë prej 1.432.643,78 eurosh.
- Një tjetër aspekt jo pak i rëndësishëm, është edhe futja dhe përfshirja e konceptit të e-book/e-libër, një risi e cila po ndikon në mbarë botën e zhvilluar dhe që në një të ardhme jo fort të largët do të përhapet si trend edhe tek lexuesi dhe editorial shqiptarë.

Amendimet në ligjin e librit synojnë të sjellin: përmirësimin e klimës së leximit dhe botimeve, uljen e çmimit të librit.

Si shembuj pozitive për të trajtuar këto ndërhyrje të qeverisë, kanë qënë edhe kuadri ligjor dhe politikat e disa prej vendeve europiane për sa i përket fushës së librit, si me poshtë:

Franca ka një politikë të caktuar në favor të librit dhe letërsisë, duke u nisur nga ligji nr.81-766 të datës 10 Gusht 1981 mbi çmimin për librin, e cila që prej vitit 2011 mbështetet mbi një disiplinë specifike të librit digjital. I ashtuquajtur ligji Lang të vitit 1981, ka si objekt kryesor kufizimin e konkurrencës në shitjen me pakicë të librit, për të mbrojtur zinxhirin e librit dhe për të nxitur leximin. Librat kanë një tatim më të ulët (TVSH 5.5%). Me përhapjen e librit digjital, ligji francez në vitin 2011 ka vendosur që çmimi të jetë unik, si për librin fizik ashtu edhe për atë digjital. Zbatimi i politikave kombëtare në territor sigurohet nga Drejtimet Rajonale të çështjeve kulturore, që vepron nën autoritetin e prefektëve rajonal dhe departamenteve.

Ligji Spanjoll nr.10/2007 parashikon tre objektiva kryesore që janë nxitja e leximit që përfshin politikën dhe gjithë shoqërinë; ruajtja e diversitetit kulturor duke siguruar shumëllojshmërinë e publikimit dhe rikonfirmimi i nocionit të librit për ta përballur me realitetin e ri teknologjik. Ligji konfirmon, ndër të tjera, vendosjen e një çmimi unik të librit, që duhet të jetë i përcaktuar nga botuesit, me një diferencë të variacionit të çmimit të shitjes në publik prej 95 % deri në 100% të çmimit fillestar. Ky sistem ofron, ashtu si në të kaluarën, disa përjashtime. Përjashtohen disa lloje librash: librat bibliofilik dhe me karakter artistik, tekstet shkollore dhe materialet didaktike. Përjashtim bëjnë raste të veçanta, të tilla si panairët dhe ekspozitat e librit, me mundësi zbritje deri në 10 % të çmimit fiks, ose shitjen në biblioteka, arkiva, muzeume, shkolla, universitete apo organizata të tjera me qëllim lidhjen e shkencës me kërkimin, me mundësi zbritje deri në 15 % të çmimit fiks.

Në Gjermani politika për promovimin e librit dhe letërsisë është e fokusuar në vlerat e diversitetit, në përfshirjen dhe cilësinë. Ligji gjerman vendos, që libri të ketë një çmim shitjeje gjithmonë të njëjtë për blerësit, çmim që është i përcaktuar nga botuesi dhe shpërndarësi, përfshirë edhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Rezultati i këtij mekanizmi është që çmimi qëndron i njëjtë si në librari, ashtu edhe në internet, me kusht që shitësi të jetë subjekt i ligjit gjerman, sepse kjo gjë nuk zbatohet për libra të blerë nga një shitës i huaj. Shoqata e botuesve mbështet fuqishëm sistemin gjerman të çmimit fiks, duke e konsideruar atë një nga mjetet më të rëndësishme për të promovuar dhe mbrojtur librat, si një mënyrë efektive për të ruajtur një rrjet të fortë të bibliotekave me një shumëllojshmëri të gjerë të librave në dispozicion të qytetarëve.

Portugalia nëpërmjet dekretit legjislativ për çmimin fiks të librit është inspiruar nga ligji francez dhe u adaptua në vitin 1996 dhe u rishikua në vitin 2000. Në përgjithësi, libri vendos një limit prej 10% të skontos së aplikuar në librat e disponueshëm në treg, por parashikon edhe taksa për skonto të ndryshme për tipologji të ndryshme. Ekziston edhe një dispozitë e veçantë për skontot e librit, përfshirë këtu edhe një fushatë për promovimin e gjuhës dhe kulturës portugeze në panairë të librit. Ndër pyetjet më të debatuar ka qenë atëherë konkurrenca mes bibliotekave të vogla dhe dyqaneve të mëdha, si dhe aktiviteteteve të falsifikimit për shkak të çmimeve të larta të librave.

Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin me nr. 01/70, te dates 19.10.2018, “Per Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, duke bere nje hap përpara, pasi ka perjashtuar nga Tatimi i Vlerës së Shtuar, të gjithë importuesit, blerësit dhe lexuesit e librit në Kosovë, gje e cila do te sjell ulje te çmimit te librit.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
 - *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*
- ✓ Përmisimi i klimës së editorisë dhe distribucionit në vend, lehtësimin e librit si produkt intelektual nga taksimi dhe ofrimi i mundësive dhe shanseve të barabarta për të gjithë komunitetin e botuesve, atë të shkrimtarëve, përkthyesve, kritikës dhe studiuesve, veprat e të cilëve përveçse pasurojnë fondit e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore në fushën e librit, janë në vetvete edhe promotorë të zhvillimit dhe gjenerimit të vlerave dhe risive në këtë fushë.
 - ✓ Lehtësimi nga numri i ekzemplarëve të kopjeve të detyruara që dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare dhe bibliotekat vendore, është një tjetër hap që ka për qëllim të reformojë dhe lehtësojë marrëdhënien ndërmjet botuesve dhe institucioneve të ruajtjes së kujtesës në vend, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standardeve bashkëkohore
 - ✓ Ndërhyrjet e kryera kanë pasur në qendër të vëmendjes, së pari ngritjen e Qendrës Kombëtare të Librit, si institucion në vartësi të Ministrisë së Kulturës, qendër e cila do t'i japë një ritëm

tjetër dhe një frymë më intensive ecurisë dhe përmirësimit të situatës aktuale të botimeve, përhapjes së librit shqip brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe promovimit të tij në hapësira të ndryshme mediatike, kulturore dhe intelektuale kudo ku gjenerohet dhe ndihet nevoja për literaturën e librit shqip dhe atij të përkthyer. Në këto kushte ngritja e Qendrës Kombëtare të Librit, do të japë ndikimin e drejtpërdrejtë në përmirësimin e kësaj marrëdhënieje dhe do të jetë një strukturë e posaçme që do të merret drejtpërsëdrejti me zbatimin e politikave dhe objektivave për librin dhe krijuesit e tij në bazë të programit të Qeverisë Shqiptare dhe përparësive në këtë fushë të rëndësishme për kulturën e shkruar.

Koordinimi me programe dhe projekte të huaja financimi, realizimi i nismave dhe jetësimi i tyre nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët vendas e të huaj, do të jetë një ndër synimet kryesore të funksionimit të këtij institucioni.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0: Status quo-ja.

Aktualisht, me ristrukturimin e institucioneve qendrore, në Ministrinë e Kulturës nuk **ka një drejtori të posaçme që merret me zbatimin e politikave të librit**. Mungon gjithashtu **një institucion varësie që të ketë në misionin e tij detyrën e zbatimit të politikave librore dhe sidomos nismat për përhapjen e librit dhe kulturës së leximit**.

Biblioteka Kombëtare, institucioni i vetëm në varësi të Ministrisë së Kulturës, është institucioni kryesor bibliotekar i vendit dhe qendër e rëndësishme studimore-kërkimore shkencore, me detyrë specifike të grumbullojë dhe të ruajë të gjithë trashëgiminë kulturore të shkruar të popullit shqiptar.

Ky institucion ka karakter shkencor dhe nuk mund të realizojë njëkohësisht edhe detyrën e edukimit masiv për përmirësimin e kulturës së leximit në shkallë vendi. Bibliotekat publike janë në varësi të bashkive të vendit dhe nuk kanë një institucion qëndror të cilit t'i referohen për një politikë të koordinuar në fushën e librit. Njëkohësisht **nuk ka një institucion të posaçëm të vëzhgimit, grumbullimit të statistikave për librin që të hartojë bazën e të dhënave për ndërtimin në vijueshmëri të politikave librore**. Kjo ka bërë që në Shqipëri të ketë mungesë të theksuar të dhënash që dokumentojnë situatën e librit dhe leximit në vend.

Aktualisht buxheti për politikën librore në Ministrinë e Kulturës është pjesë e buxhetit për artin dhe kulturën, dhe paraqitet i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat **për një program të qëndrueshëm e afatgjatë për edukimin përmes librit dhe leximit**.

Ligji aktual për Librin paraqitet i paplotë dhe me mangësi për të përballuar zhvillimet e kohës.

Ligji aktual i ngarkon shtëpitë botuese me kosto të larta botimi, të cilat janë në formën e TVSH-se së shtypshkrimit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e çmimit të librit. Për materializimin e veprimtarisë krijuese të shkrimtarit, në bazë të kontratës që lidhet midis krijuesit dhe shtëpisë botuese, kjo e fundit duhet të paguajë shpenzime operative të realizimit të botimit shtypshkronjave, plus TVSH-në. Për rrjedhojë, kemi rritje automatike të çmimit të librit. Në këto kushte, bazuar në analizën e situatës të librit dhe leximit në Shqipëri, nevojitet ndërmarrja e politikave lehtësuese, siç është dhe ulja e TVSH-së.

Nuk ka gjithashtu masa lehtësuese për pasurimin e bibliotekave shkollore dhe publike.

Mungojnë në ligjin aktual lehtësirat për librin elektronik, një prej zhvillimeve më të rëndësishme në të ardhmen në fushën e librit.

Opsioni 1: Opsioni 1 është i preferuar me status quo-në, sepse synon zgjidhjen e ngërçeve dhe problemeve të krijuara nga mungesa e institucioneve që kanë si objekt parësor zbatimin e politikave librore në vend, si dhe problemeve të krijuara nga mangësitë në kuadrin ligjor aktual.

Krahasuar me status quo-ne, opsioni 1 synon pikërisht të rregullojë këto problematika duke synuar të ndryshojë situatën në vend lidhur me librin dhe leximin, do të mundësojë *lehtësimin e zbatimit të politikave të librit*, krijimin e kushteve për *rritjen e kapaciteteve financiare dhe shtimin e burimeve njerëzore* në dispozicion për fushën e librit, rritjen e mundësisë për sigurimin e *fondeve të jashtëme dhe burimeve të tjera ndihmëse financiare* në fushën e librit, përfshirjen më të gjerë të krijuesve, përkthyesve dhe botuesve në projektet e librit dhe nxitjes së leximit.

Krijimi i një qendre të posaçme për librin do të bënte të mundur rritjen e kapaciteteve financiare meqenëse vetëm si e tillë, si institucion varësie me status të përcaktuar, mund të ishte pjesë e programeve ndërkombëtare për kulturën e veçanërisht për librin dhe leximin. Qendra gjithashtu do të mundësonte hartimin dhe zbatimin e një strategjie ndërgjegjësimi në shkallë kombëtare për rëndësinë e librit dhe leximit, do të mundësonte mbledhjen e të dhënave dhe statistikave, të munguara deri tani për librin dhe leximin, do të mundësonte promovimin më efikas të letërsisë shqipe brenda dhe jashtë vendit, do të mundësonte krijimin e një rrjeti bashkëpunues dhe mbështetës mes shkollës, familjes, institucioneve librare e bibliotekare.

Së dyti ndryshimet në ligjin aktual të librit do të ndihmonin për të lehtësuar barrën fiskale të botuesve dhe ulur çmimin e librit. Përmirësimet në këtë ligj gjithashtu do të bëjnë decentralizimin e politikës së librit nëpërmjet krijimit të një Qendre për Librin dhe Leximin e cila do të funksionojë si organ (me VKM). Në këtë mënyrë ne dëmtojmë shtypshkronjat vendase duke i bërë jokonkurrenente me ato të vendeve fqinje.

Ndërkohë që kjo TVSH që rëndon mbi shtypshkronjat vendase, efektivisht pasqyrohet në çmimin e shitjes së librit, sepse është pjesë reale e kostos së prodhimit për sa kohë nuk është e zbatueshme. Amendimet e ligjit në fjalë që konsistojnë në përmirësimin e klimës së editorisë dhe distribucionit në vend, lehtësimin e librit si produkt intelektual nga taksimi dhe ofrimi i mundësive dhe shansave të barabarta për të gjithë komunitetin e botuesve, atë të shkrytarëve, përkthyesve, kritikës dhe studiuesve, veprat e të cilëve përveçse pasurojnë fondit e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore në fushën e librit, janë në vetvete edhe promotorë të zhvillimit dhe gjenerimit të vlerave dhe risive në këtë fushë.

Ndërhyrjet e kryera në disa nene të rëndësishme të këtij projektligji kanë pasur në qendër të vëmendjes dhe synojnë një përmirësim të ndjeshëm të afrimit dhe përhapjes së librit shqip brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe promocionit të tij në hapësira të ndryshme mediatike, kulturore dhe intelektuale, kudo ku gjenerohet dhe ndihet nevoja për literaturën e librit shqip dhe atij të përkthyer. Në këto kushte, përshtatja e një terreni të mbarsur me një problematikë të trashëguar pas një procesi të gjatë tranzitiv, do të japë ndikimin e drejtpërdrejtë në përmirësimin e kësaj marrëdhënieje dhe do të përbëjë një dokument të rëndësishëm si shenjë e përkundjesjes nëpërmjet politikave specifike dhe zbatimit të objektivave për librin dhe krijuesit e tij, bazuar edhe në programin e Qeverisë Shqiptare dhe përparësive të saj, në këtë fushë të rëndësishme për kulturën e shkruar.

Lehtësimi nga numri i ekzemplarëve të kopjeve të detyruara që dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare dhe bibliotekat vendore, është një tjetër hap që ka për qëllim të reformojë dhe lehtësojë marrëdhënien ndërmjet botuesve dhe institucioneve të ruajtjes së kujtesës në vend, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standarteve bashkëkohore.

Gjithashtu, në draftin që po paraqitet për amendim shprehet vullneti për të lehtësuar Bibliotekën Kombëtare dhe rrjetin e bibliotekave publike në Shqipëri nga procedura e prokurimit, në ato raste kur bëhet fjalë për blerjen e librave dhe materialeve të një rëndësie të

veçantë që hyjnë në kategorinë e fondeve të rralla, të cilat në asnjë rast nuk mundet të tenderohen për vet specifikën e tyre.

Argumenti: Amendimet në ligjin e librit synojnë të sjellin: përmirësimin e klimës së leximit dhe botimeve, uljen e çmimit të librit.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbliidhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Kjo politikë intensifikon marrëdhënien e bashkëpunimit në tri plane: autor-botues; botues-komunitet; shteti-shoqëria.

- Kjo politikë do të sjellë lehtësimin prodhimit të librit si produkt intelektual nga taksimi dhe ofrimi i mundësive dhe shanseve të barabarta për të gjithë komunitetin e botuesve, atë të shkrimtarëve, përkthyesve, kritikës dhe studiuesve, veprat e të cilëve përveçse pasurojnë fondit e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore në fushën e librit, janë në vetvete edhe promotorë të zhvillimit dhe gjenerimit të vlerave dhe risive në këtë fushë.

Grupët e prekura në këtë potlike janë:

Institucionet: Ndryshimet e kuadrit rregullator synojnë ngritjen e Qendrës së Librit të Lëximit, e cila nuk po shoqërohet me efekte financiare shtesë pasi numri i përgjishëm I punonjësve do mbulohet nga ristrukturimi bibliotekës Kombëtare dhe mbylljesë Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit.

Shoqata e Botuesve: Përfitimi kryesor ekonomik që pritet të vijë si rezultat i kësaj politike është lehtësimi nga plotika fiskale e uljes së TVSH, që do të ndikojë dretpërdrejtë në uljen e kostove të prodhimit të librit dhe uljes së çmimit të shitjes së librit të konsumatori. Në këtë kuader kjo do të ndikojë në rritjen e leximit.

Ekziston tashmë një “emergjencë leximi” në Shqipëri që reflektohet në të gjitha fushat: dije të cekëta, përgatitje sipërfaqësore për të përballuar sfidat e kohës, mungesë imagjinatë për hartime projektesh e gjetje rrugëdaljeje. Fati i një vendi dhe në planin ekonomik e social është i lidhur ngushtë me fatin e librit: ku ka dije, ku ka bibliotekë, ku lexohet, ka dhe ide novative, ka gjithnjë një shteg të ri për të dalë nga situatat e vështira, për t’u matur me botën me inteligjencë dhe mençuri.

Kerkohet të që aplikimi I TVSH-së të vijë në nivelet europiane. Kjo lloj politike do të shmangë dhe evazionin fiskal dhe informalitetin.

Përfitimet indirekte: Ministria Kulturës ka filluar ndërhyrjet me një plan sistematik, të vazhdueshëm e afatgjatë. Një plan Kombëtar që të ketë sukses ka nevojë për një përfshirje dhe bashkërenditje të punës me të gjitha strukturave dhe aktorëve të librit, shtetërore dhe private: biblioteka, librari, shtëpi botuese. Me ngritjen e QKLL-së si dhe me një mbështetje financiare nga shteti, nëpërmjet Fondit për Librin dhe Leximin: Plani nis me analizë të gjendjes:

Sa lexohet, grupmosha e lexuesve, shpërndarja territoriale, ndikimi i shkollës dhe i situatës familjare, shpërndarja e librit dhe librarive në vend, gjendja e bibliotekave etj.

(Database dhe observues të të dhënave).

Shpërngulja e të rinjve nga leximi letër në leximin dixhital kërkon politikë fiskale ndihmuese për librin dixhital me qëllim ngritjen e platformave dixhitale dhe përfshirjen e librit shqip në platformat dixhitale ndërkombëtare. Mosshpërndarja e librit në zonat periferike: mungësa e bibliotekave dhe e librarive. Emergjencia e një plani për bibliotekat në rang kombëtar dhe krijimin e kushteve lehtësuese për biznesin e librarive, për një rrjet librarish në të gjithë.

Bibliotekat promovimi të kulturës së leximit e cila do të realizohet me lehtësisht nëpërmjet ngritjes së QKLL-së e cila do të ketë një staf të dedikuar që do të mërret me zbatimin e projekteve për librin. Nëpërmjet këtij rrjeti do të realizohet, (ka filluar që tani nga MK) :

a) Bashkëpunim me institucionet shkollore për një politikë në mbështetje të librit dhe leximit; aktivizimi i bibliotekave shkollore,

b) Krijimi i rrjeteve bashkëpunuese mes institucioneve që promovojnë leximin: shkolla, universitete, biblioteka, librari etj.

c) Promovimi i librit shqip jashtë vendit përmes mbështetje së përkthimit nga gjuha shqipe dhe pranisë në panairë ndërkombëtare;

d) Fuqizim të bibliotekave shkollore e vendore.

e) Krijimi i një klime favorizuese për përhapjen e librit dhe leximit përmes përfshirjes së profesionistëve të fushës: botues, përkthyes, shkrimtarë, mësues etj.

Shkollat: t’i jepet përparësi praktikës së leximit nëpër shkolla, si një veprimtari e rëndësishme për të zhvilluar aftësi autonome për kërkimin, për reflektimin kritik, për rritjen e imagjinatës dhe për maturimin e nxënësve të të gjitha niveleve, duke filluar që tek parashkollorët. (Plani në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit)

të rritet funksioni i tyre kulturor e ndërkulturor, duke u kthyer në Qendra leximi dhe Bibliotekat promovimi të kulturës së leximit. (Plani në bashkëpunim me qeverisjen vendore)

Prioritete: Bashkëpunim me institucionet shkollore për një politikë në mbështetje të librit dhe leximit; aktivizimi i bibliotekave shkollore,

Krijimi i rrjeteve bashkëpunuese mes institucioneve që promovojnë leximin: shkolla, universitete, biblioteke, librari etj. Promovimi i librit shqip jashtë vendit përmes mbështetje së përkthimit nga gjuha shqipe dhe pranisë në panairë ndërkombëtare;

Fuqizim të bibliotekave shkollore e vendore.

Krijimi i një klime favorizuese për përhapjen e librit dhe leximit përmes përfshirjes së profesionistëve të fushës: botues, përkthyes, shkrimtarë, mësues etj.

Për prioritetin 1. Bashkëpunim me institucionet shkollore për një politikë në mbështetje të librit dhe leximit; aktivizimi i bibliotekave shkollore,

Prioriteti 2: Krijimi i rrjeteve bashkëpunuese mes institucioneve që promovojnë leximin: shkolla, universitete, biblioteke, librari etj.

Prioriteti 3: Promovimi i librit shqip jashtë vendit përmes mbështetje së përkthimit nga gjuha shqipe dhe pranisë në panairë ndërkombëtare;

Prioriteti 4: Fuqizim të bibliotekave shkollore e vendore.

Prioriteti 5: Krijimi i një klime favorizuese për përhapjen e librit dhe leximit përmes politikave fiskale lehtësuese, përfshirjes së profesionistëve të fushës: botues, përkthyes, shkrimtarë, mësues, gazetarë, media e shkuar dhe elektronike, etj.

MK-ja ka vlerësuar si prioritet fushën e librit ku përmes një buxheti specifik prej 30.000 leke/në vit, nga programi art-kulture ka hartuar dhe mbështetur projekte që promovojnë librin shqip dhe atë të përkthyer në vlerat me përfaqësuese të tij. Kjo politikë ka konsistuar edhe në prezantimin e editorisë shqiptare në evnimente të rëndësishme ndërkombëtare si panairi i librit në Torino, Lajpzig etj. Nderkohe janë koordinuar fondet dhe politikat edhe nëpërmjet programeve europiane për kulturën e në veçanti për librin “Europa Krijuese” dhe “Traduki”, me anë të aderimit dhe marrjes përsipër të pagese se kuotizimit të anëtarësimit në këto struktura të rëndësishme ndërkombëtare, ku shoqatat kulturore dhe shtëpitë botuese kanë përfituar një fond prej 1.432.643,78 eurosh. Këto janë fonde që pasurojnë tregun e librit, por të orientuara për shoqëritë dhe organizmat privatë.

Gjithsesi akordimi i këtyre fondeve financiare duhet të përgjigjet një politikë sa kulturore aq edhe fiskale, nëpërmjet harmonizimit të këtyre dy komponentëve kyç do të arrijmë të krijojmë një platforme me rritje progresive si në drejtim të gjenerimit të ideve të lidhura me produktin ashtu edhe sa i përket rezultatit ekonomik vendas.

Perfitimet në makro – nga reduktimi i TVSH-sën sjell rritjen e lexueshmerisë, rrit shitjen e librave, formalizon me shume këte lloj aktiviteti, rrit vlerën e përgjithshme të nivelit intelektual dhe mendimit arsyetues dhe kritik në shoqëri, të tjera.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 1, i cili është opsioni i preferuar, synon të rregullojë situatën në vend lidhur me librin dhe leximin, duke mundësuar *lehtësimin e zbatimit të politikave të librit*, krijimin e kushteve për *rritjen e kapaciteteve financiare dhe shtimin e burimeve njerëzore* në dispozicion për fushën e librit, rritjen e mundësisë për sigurimin e *fondeve të jashtme dhe burimeve të tjera ndihmëse financiare* në fushën e librit, përfshirjen më të gjerë të krijuesve, përkthyesve dhe botuesve në projektet e librit dhe nxitjes së leximit.

Krijimi i një qendre të posaçme për librin do të bënte të mundur rritjen e kapaciteteve financiare meqenëse vetëm si e tillë, si institucion varësie me status të përcaktuar, mund të ishte pjesë e programeve ndërkombëtare për kulturën e veçanërisht për librin dhe leximin.

Qendra gjithashtu do të mundësonte hartimin dhe zbatimin e një strategjie ndërgjegjësimi në shkallë kombëtare për rëndësinë e librit dhe leximit, do të mundësonte mbledhjen e të dhënave dhe statistikave, të munguara deri tani për librin dhe leximin, do të mundësonte promovimin më efikas të letërsisë shqipe brenda dhe jashtë vendit, do të mundësonte krijimin e një rrjeti bashkëpunues dhe mbështetës mes shkollës, familjes, institucioneve librare e bibliotekare.

Së dyti ndryshimet në ligjin aktual të librit do të ndihmonin për të lehtësuar barrën fiskale të botuesve dhe ulur çmimin e librit. Me heqjen e TVSH për prodhimin e librave nga shtypshkronjat shqiptare, Librat që shtypen jashtë Shqipërisë, nuk ngarkohen me pagesën e kësaj TVSH - kusht i BE-së.

Argumenti: Amendimet në ligjin e librit synojnë të sjellin: përmirësimin e klimës së leximit dhe botimeve, uljen e çmimit të librit.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin e opsionit të përzgjedhur institucionet përgjegjëse do të jenë Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e vetëqeverisjes vendore, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, Biblioteka Kombëtare dhe instancat akademike në R.SH.

Pengesa të mundshme dhe sfidat kryesore mbeten harmonizimi dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor në R.SH si ligji i prokurimeve, ligji mbi TVSH-në etj.

Hartimi i një plani veprimi ku do të përfshihen të gjithë aktoret kryesore që kanë ndikim dhe rezultat të drejtperdrejte në këto fushe.

Vënia në efikasitet të plotë dhe në koherencë të institucioneve të varësisë (QKLL – BK) me të gjitha detyrimet që lindin nga legjislati shqiptar për librin dhe relatimi i herëpashershëm mbi gjithë ecurinë e këtij procesi pranë MK-se.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi i opsionit që do të zbatohet do të kryhet nëpërmjet treguesve statistikore, të cilët përditësohen çdo muaj nga struktura e posaçme në MK, të cilët testojnë terrenin dhe zbatimin e politikave shtetërore nëpërmjet një plani të përcaktuar ku merren në analizë të gjitha hallkat përgjegjëse kundrejt të dhënave buxhetore, përfitimit nëpërmjet këtyre politikave si edhe rezultati që sjellin në lidhje me frekuentueshmërinë dhe bashkëpunimin ndërmjet grupeve të interesit dhe komunitetit.

Gjithashtu nëpërmjet formulareve që plotësohen me të gjithë të dhënat burimore nga institucionet e varësie por edhe nga grupet e interesit nëpërmjet mbështetjes me projekte specifike, do të mund të përvijohet një tablo e qarte e matshme dhe me kronologji statistikore për të gjithë treguesit mbi të cilët funksionojnë këto institucione.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			